



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P.597/2017**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.08.2017 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Tower” shpk nga procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozime*”, me Nr. REF-16721-06-06-2017, me objekt “Mbikqyrje e objektit “Ndertim i parkut japonez dhe kopshteve të komunitetit”, me fond limit 1.350.850 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 19.06.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Korçë.

**Ankimues :** “Tower“ shpk  
Rr.”Fadil Rada”, pallati “Daniela” shk.2, kati 3, ap.9, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Korçë  
Rruga “28 nëntori”, Korçë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

## Vëren:

### I


#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator i ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.



### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.06.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozime*”, me Nr. REF-16721-06-06-2017, me objekt “Mbikqyrje e objektit “Ndertim i parkut japonez dhe kopshteve te komunitetit”, me fond limit 1.350.850 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 19.06.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Korçë.

II.2. Në datën 19.06.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 22.06.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

Zenit-06	795.000 lekë	i skualifikuar
Gjeokonsult&Co	870.000 lekë	i skualifikuar
MAK Studio	931.000 lekë	i skualifikuar
A.Sh Engineering	1.100.000 lekë	i skualifikuar

He-SK	1.162.690 lekë	i skualifikuar
Tower	1.235.930 lekë	i skualifikuar
Novatech studio	1.250.418,6 lekë	i kualifikuar

II.4. Në datën 22.06.2017 operatori ekonomik “Tower” shpk, është njoftuar për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

*“Vlera e ofertes eshte me e ulet se vlera minimale e lejuar sipas VKM Nr 354 date 11.05.2016 “Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim.”*

II.5. Në datën 23.06.2017 operatori ekonomik “Tower” shpk., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij të dhëna nga autoriteti kontraktor. Konkretisht ankimuesi në ankesën e tij pretendon si më poshtë:

*“Nga mesazhi elektronik i refuzimit te ofertes, konstatojme se Autoriteti Kontraktor nuk i eshte referuar ligjit dhe rregullave te prokurimit publik ne lidhje me zbatimin e formules per oferten anomalisht te ulet, por ka bere vleresimin referuar vleres minimale te fondit limit, duke percaktuar nje diapazon te ketij te fundit per te kualifikuar/skualifikuar operoret ekonomike pjesemarres. Kete qendrim ka mbajtur dhe KPP ne vendimarrjet e tij dhe konkretisht ne vendimin KPP 660/2015”.*

II.6. Në datën 30.06.2017, me shkresën nr. 2994/1 prot, operatori ekonomik ankimues “Tower” shpk është vënë në dijeni në lidhje refuzimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 06.07. 2017 operatori ekonomik ankimues “Tower” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.3254/1 prot, datë 14.07.2017 protokolluar me tonën me numër 1245/2, datë 17.07.2017 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Tower” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit “Vlera e ofertes eshte me e ulet se vlera minimale e lejuar sipas VKM Nr 354 date 11.05.2016 “Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.1.2. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.1.3. Në nenin 53, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave [...]”.

III.1.4. Në nenin 56 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.1.5. Konstatohet se autoriteti kontraktor nuk i është referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik në lidhje me zbatimin e formulës për ofertën anomalisht të ulët, por ka bërë vlerësimin referuar vlerës minimale të fondit limit, duke përcaktuar një diapazon të këtij të fundit për të kualifikuar/skualifikuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk është e pranueshme që autoriteti kontraktor të kryejë apo të pretendojë të kryejë vlerësimin e ofertave ekonomike duke vendosur kufij

minimalë, nën të cilin do të skualifikohen automatikisht ofertat ekonomike të operatorëve pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, pasi kjo vjen në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, sipas të cilit fillimisht zbatohet formula për të vlerësuar nëse një ofertë është anomalisht e ulët ose jo dhe më pas, në varësi të rezultatit, autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë sqarimet dhe dokumentacionin me të cilin ky i fundit argumenton elementët e veçantë të ofertës së tij ekonomike, duke mbajtur në konsideratë edhe legjislacionin e posaçëm që rregullon tarifën për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim.

Përcaktimi i kufijve të tillë, bie në kundërshtim edhe me vetë frymën dhe qëllimin e ligjit të përcaktuar në nenin 1 të tij, duke frenuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të këtyre operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Tower” shpk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri



1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Tower” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozime”, me Nr. REF-16721-06-06-2017, me objekt “Mbikqyrje e objektit “Ndertim i parkut japonez dhe kopshteve të komunitetit”, me fond limit 1.350.850 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 19.06.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Korçë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Tower” shpk duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Tower” shpk.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.1245 Protokoli, Datë 06.07.2017**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**

